



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.12.2020, ora 14.30

(i përmbledhur)<sup>1</sup>

**Drejton mbledhjen -  
Vitore Tusha – zv/Kryetar i Këshillit**

*Rendi i Ditës:*

*1. Miratimi i procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes të KED-së të datës 26.11.2020.*

**Marrin pjesë :**

- |                      |              |
|----------------------|--------------|
| 1. Vitore Tusha,     | (zv/Kryetar) |
| 2. Fiona Papajorgji, | (anëtare)    |
| 3. Arta Marku,       | (anëtare)    |
| 4. Saida Dollani,    | (anëtare)    |
| 5. Ludovik Dodaj,    | (anëtare)    |

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:**

1. **Avokati i Popullit**, përfaqësuar me autorizim nga **Enio Haxhimihali**,

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:**

1. **Bledar Dervishaj**, përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës.
2. **Mimoza Arbi**, përfaqësuese me autorizim e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

### HAPET MBLEDHJA

**Vitore Tusha** hap mbledhjen dhe parashtron se kjo mbledhje është thirrur vetëm për miratimin e përmbledhjes së procesverbalit për të ndihmuar procesin që vijon në gjykatën e apelit dhe që lidhet me ankimin e kandidatëve që janë ndaluar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me qëllim që të mundësohet pajisja e gjykatës dhe e kandidatëve me gjithë aktet procedurale të nevojshme për procedurë.

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Sqaron se ka dy mungesa, konkretisht anëtarët Miranda Andoni dhe Fatjona Memçaj, të cilat kanë njoftuar për pamundësinë objektive të pranisë në mbledhje. Deklaron se kuorumi është i mjaftueshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Avokati i Popullit përfaqësohet me autorizim nga z. Enio Haxhimihali.

I jep fjalën përfaqësuesit të Avokatit të Popullit.

**Enio Haxhimihali** kërkon ndjesë për pamundësinë e Avokates së Popullit për të marrë pjesë në këtë mbledhje, pasi kishte si shkak një konferencë në të cilën duhet të referonte. Sqaron se e ka dorëzuar në sekretari autorizimin për përfaqësim, ndërsa për procesverbalin mendimi është dërguar paraprakisht mendimin dhe nuk ka vërejtje.

**Vitore Tusha** pyet nëse ka ndonjë gjë për procedurë përfaqësuesi i Presidentit dhe Kryetarit të Kuvendit.

**Bledar Dervishaj** dhe **Mimoza Arbi** përgjigjen se nuk kanë gjë për të thënë.

**Vitore Tusha** vijon me miratimin e rendit të ditës. Propozon të miratohet procesverbali i datës 23.11.2020, me përmbajtjen e të cilit janë njohur të gjithë dhe kanë dhënë vlerësimin e komentet.

**Anëtarët** shprehen se janë dakord me rendin e ditës dhe miratojnë procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes të KED të datës 26.11.2020.

**Bledar Dervishaj** kërkon fjalën dhe parashtrohet kërkesën për Këshillin apo kryetaren nëse mund të ketë informacion në lidhje me proceset e tjera gjyqësore të hapura nga kandidatët e ndaluar dhe në çfarë faze janë, duke kërkuar ndonjë informacion më të azhornuar për proceset që kanë hapur kandidatët e ndaluar së fundmi.

**Vitore Tusha** përgjigjet se informacione i ka të plota por deri tani nuk ka ankim tjetër përveç atyre që janë bërë publike dhe që janë komunikuar në mbledhjen e mëparshme. Sqaron edhe se njëri nga kandidatët sot ka ditën e fundit të afatit sepse fletëthirrja është i komunikuar nga posta në datën 30, ndërsa kandidati tjetër nuk ka bërë ankim dhe atij i ka përfunduar afati. Lidhur me dy kandidatët e vakancës tjetër të Presidentit ka përfunduar shqyrtimi në lidhje me njërin kandidat, ndërsa në lidhje me kandidatin tjetër në cilësinë e relatores ka pasur dhe disa verifikime të domosdoshme për t'i kryer dhe i ka drejtuar disa pyetje për të cilat pret përgjigje këto ditë.

**Enio Haxhimihali** pyet nëse këtë javë ka më mbledhje.

**Vitore Tusha** përgjigjet se mbledhjet mund të bëhen dhe menjëherë sapo të ketë vendim. Ky është vullneti i KED që të thirret çdo moment, pasi po punohet që të kemi një Gjykatë Kushtetuese, nuk është punuar në asnjë moment me dredha apo që të mos kemi një Gjykatë Kushtetuese.

**Saida Dollani** ndërhyr dhe si relatore e vakancës së Kuvendit shprehet se ajo e ka gati, pra se ka bërë të gjitha veprimet paraprake për sa i përket kandidaturës se mbetur të lejuar, por është në pritje të veprimtarisë së zonjës Buna që sot përfundoi, për tja paraqitur këshillit. Ngre shqetësimin në lidhje me radhën që do të ndiqet, a pengon radha diçka apo institucionet janë marre vesh me njëra tjetrën për të çuar listat pa një radhë të caktuar. Pyet zv/kryetaren nëse ka ndonjë informacion nga institucionet.

**Vitore Tusha** shprehet se nuk ka asnjë të tillë përveç sa kanë deklaruar institucionet këtu.

**Bledar Dervishaj** shprehet se: “E kemi thënë dhe herë të tjera që ne (Institucioni i Presidentit të Republikës) do të shprehemi kur të vijë ai moment procedural. Këtu do shprehemi, do të shprehemi me shkresë, apo do të shprehemi përmes përfaqësuesve. Ajo që mund t'ju kujtoj është fakti që, Opinioni Final i Komisionit të Venecias (Opinioni nr. 978/2020) kërkon edhe mirëkuptim ndërmjet institucioneve sidomos në rastet kur numri i kandidaturave, është i vogël. Kjo ka të bëjë me radhën, dhe shqetësimin që ngre relatorja. Pas Opinioni të Komisionit të Venecias u realizua një takim (30.06.2020) midis dy autoriteteve, Presidentit dhe Kryetarit të Kuvendit, ku u ra dakord nisja nga puna në nivel ekspertësh. Në atë takim Presidenti i bëri me dije Kryetarit të Kuvendit se Bledi (dmth unë) ishte eksperti i tij, dhe presim që Kuvendi të

sjellin ekspertin e tyre për këtë qëllim. Për këtë detaj, ne ende dhe sot nuk kemi një përgjigje nga Kuvendi për ekspertin e tyre. Megjithatë referuar shqetësimin të relatores, mendoj që kur t'i vijë radha këtij momenti, Kuvendi do jetë këtu dhe do të duhet të shprehet. Presidenti do të jetë këtu i përfaqësuar dhe do të shprehet.

**Mimoza Arbi** shprehet se referuar rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe referuar gjendjes konkrete të kandidaturave për të cilat kërkojmë sjelljen e tyre pranë organeve të emërtesës dhe emërimin e tyre nuk është domosdoshmërisht që duhet të ndiqet radha. Në qoftë se procedura për kandidaturat e Kuvendit përfundon më shpejt ajo mund të vijë, megjithatë referuar dhe parashtrimeve të përfaqësuesit të Presidencës, besoj se mirëkuptim siç ka filluar ashtu do vazhdojë midis dy institucioneve për të mos u bërë pengesë për funksionimin sa më parë të Gjykatës Kushtetuese me emërimin apo zgjedhjen anëtareve për vendet vakant për Gjykatën Kushtetuese.

**Vitore Tusha** shprehet: “Unë do shtoja në lidhje me këtë që thatë që jo pa qëllim në frymën e rekomandimeve të Komisioneve të Venecias, në korrik kemi miratuar edhe ndërhyrjen në aktin tonë nënligjor që bën fjalë edhe për kompetencën e Këshillit për të vendosur në lidhje me mënyrën e dërgimit të tij, çështje që duken në formën e parë procedurale, por mund të kapërcejmë këto elemente, pra nuk do kalojë gjë pa vëmendjen e Këshillit, do përcaktohen në rendin e ditës menjëherë çështjet sapo të ketë mbaruar vakanca dhe nuk do vonojmë asnjë ditë. I përket Këshillit në këtë moment që ta vendosë, jo vetëm dërgimin, renditjen por edhe mënyrën e dërgimit kështu që këtë ia kemi vënë vetes si kompetencë dhe do ta zbatojmë me shumë korrektësi.”

**Bledar Dervishaj:** “Pa dashur të zgjatem, ju na sollët diçka në kujtesë që është e vërtetë. Kur u hartuan ndryshimet e akteve nënligjore të këshillit (*ndryshimet që reflektonin rekomandimet e K.Venecias*), më kujtohet që kjo çështje ka marrë diskutim. Nuk ju la rastësisë, apo vetëm vullnetit të organeve të emërtesës, apo dakortësisë midis tyre, por këshilli përcaktoi se do të vendosë edhe mbi mënyrën e dërgimit të listave tek organet e emërtesës. Nuk jemi në atë moment pavarësisht se situata që ngre relatorja paraqet shqetësim dhe për këtë ka të drejtë. Situata po zhvillohet në dinamikë, si psh., sot kishim një proces gjyqësor që përfundoi. Nesër mund të kemi, ose mund të mos kemi, gjithsesi ende nuk ka ardhur ai moment për të kërkuar qëndrimin tonë. Gjithësesi këshilli e ka të gjithë atributin për të vendosur edhe për ta zgjidhur këtë situatë e cila mund të ngel në ngërç, nga organet emërtesës, por që s`ma do mendja se do të ngelë.

**Vitore Tusha** deklaroi mbylljen e mbledhjes për të vijuar me pikën tjetër të rendit të ditës, procedurën e vendimmarrjes për kandidatët.

**Mbyllet mbledhja në orën 14.45.**

**Tiranë më datë 07.12.2020**

**Zv/KRYETARE**

**Vitore TUSHA**